



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 118

Tiranë – E premte, 24 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 43/2016 datë 21.4.2016	Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë..... 8303
Ligj nr. 65/2016 datë 9.6.2016	Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë..... 8312
Ligj nr. 66/2016 datë 9.6.2016	Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë..... 8318
Vendim i Kuvendit nr. 40/2016, datë 9.6.2016	Për rrëzimin e dekretit nr. 9577, datë 5.5.2016, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë””..... 8324
Vendim i Kuvendit nr. 41/2016, datë 9.6.2016	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazës së të dhënave shtetërore tatimore, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 8/2016..... 8325
Vendim i Kuvendit nr. 42/2016, datë 9.6.2016	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore..... 8325
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 455, datë 22.6.2016	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Spartak Braho..... 8325
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 22.6.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 1093, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave, të kriterëve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit” 8326



LIGJ
Nr. 43/2016

PËR MARRËVESHJET
NDËRKOMBËTARE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat e lidhjes dhe përfundimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventën e Vjenës “Për të drejtën e traktateve”, 1969, aderuar me ligjin nr. 8696, datë 23.11.2000, dhe konventën e Vjenës “Për të drejtën e traktateve” ndërmjet shteteve dhe organizatave ndërkombëtare ose ndërmjet organizatave ndërkombëtare, 1986, aderuar me ligjin nr. 18/2014, datë 27.2.2014.

Neni 2
Objekti

Ky ligj zbatohet për të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, të lidhura në formë të shkruar, sipas së drejtës ndërkombëtare publike, pavarësisht nga emërtimi i tyre, ndërmjet institucioneve shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të shteteve të tjera ose organizatave ndërkombëtare.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj temat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Alternat” është përparësia e renditjes së palëve në tekstin e një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku në dosjen e marrëveshjes së secilës palë emri i saj shfaqet i pari në raport me palën tjetër.

b) “Autorizim për lëshimin e plotfuqisë /kredencialeve” është autorizimi që Presidenti i Republikës ose Kryeministri i jep ministrit të Punëve të Jashtme për lëshimin e plotfuqisë /kredencialeve, nënshkrimin marrëveshjeve ndërkombëtare ose pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare.

c) “Denoncim” është akti, me të cilin Republika e Shqipërisë tërhiqet nga një marrëveshje ndërkombëtare.

ç) “Kredenciale” është dokumenti që lëshohet nga autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë, që autorizon një ose disa persona të marrin pjesë në një konferencë ndërkombëtare, të votojnë apo të nënshkruajnë aktet finale të konferencës.

d) “Marrëveshje ndërinstitucionale” është marrëveshja me karakter teknik, e lidhur në emër të dhe në bazë të kompetencave të ministrive, institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe të enteve publike të Republikës së Shqipërisë me institucionet përkatëse të shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare.

dh) “Marrëveshje ndërkombëtare” është instrumenti i hartuar sipas së drejtës ndërkombëtare publike, që lidhet ndërmjet institucioneve shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të tjera apo organizatave ndërkombëtare, pavarësisht nga forma dhe emërtimi i tij.

e) “Miratim në parim” është akti, me anë të të cilit Këshilli i Ministrave miraton projektet e marrëveshjeve të paraqitura nga ministritë kompetente para nënshkrimit të tyre.

ë) “Parafim” është akti, me të cilin personat e autorizuar vënë inicialet për të treguar se kanë rënë dakord për tekstin përfundimtar të marrëveshjes.

f) “Plotfuqi” është dokumenti që lëshohet nga autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë, që autorizon një ose disa zyrtarë të përfaqësojnë shtetin apo Qeverinë në zhvillimin e negociatave, parafimin dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare.

g) “Ratifikim, pranim, aderim, miratim” është akti juridik, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin e saj për të qenë palë në një marrëveshje ndërkombëtare, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.



gj) “Rezervë” është deklarata e njëanshme që lëshohet nga autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, aderimit, miratimit ose pranimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, me anë të së cilës synon të përjashtojë ose të ndryshojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara të saj.

KREU II PËRGATITJA E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

Nenin 4

Përgatitja e marrëveshjeve ndërkombëtare

Projektet e marrëveshjeve ndërkombëtare përgatiten nga ministritë, institucionet qendrore e vendore, si dhe entet publike, në përputhje me Kushtetutën, të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5

Subjektet e marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Marrëveshjet ndërkombëtare mund të lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose në emër të Këshillit të Ministrave.

2. Marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë mund të nënshkruhen nga Presidenti i Republikës ose nga Kryeministri, anëtarët e Këshillit të Ministrave apo çdo zyrtar i lartë, në çdo rast me autorizim nga Presidenti i Republikës.

3. Marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Këshillit të Ministrave mund të nënshkruhen nga Kryeministri ose nga anëtarët e Këshillit të Ministrave apo çdo zyrtar i lartë, në çdo rast me autorizim nga Kryeministri.

4. Një marrëveshje ndërkombëtare, që lidhet në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave, mund të nënshkruhet nga ministri i Punëve të Jashtme ose ambasadori i misionit diplomatik me shtetin ku është akredituar.

Neni 6

Plotfuqitë për marrëveshjet ndërkombëtare

1. Përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë, të autorizuar për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, pajisen me plotfuqi nga autoriteti kompetent pas miratimit në parim të projekt marrëveshjes nga Këshilli i Ministrave.

2. Përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë, të autorizuar për negocimin dhe parafimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të parashikuara në nenin 121, pika 1, të Kushtetutës, pajisen me plotfuqi.

3. Autoritetet kompetente për lëshimin e plotfuqive janë si më poshtë:

a) kur marrëveshja ndërkombëtare që negociohet dhe/ose nënshkruhet është në emër të Republikës së Shqipërisë, plotfuqia lëshohet nga ministri i Punëve të Jashtme, pas autorizimit të dhënë nga Presidenti i Republikës;

b) kur marrëveshja ndërkombëtare që negociohet dhe/ose nënshkruhet është në emër të Këshillit të Ministrave, plotfuqia lëshohet nga ministri i Punëve të Jashtme, pas autorizimit të dhënë nga Kryeministri;

c) në rastet e përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, kërkesa për lëshimin e plotfuqisë i drejtohet autoritetit kompetent për lëshimin e autorizimit nga institucioni që ka iniciativën për lidhjen e marrëveshjes, të shoqëruar nga teksti i projekt marrëveshjes dhe një relacion shpjegues.

4. Ministria e Punëve të Jashtme përgatit plotfuqinë brenda shtatë ditëve pune nga data e marrjes së autorizimit nga autoriteti kompetent, sipas parashikimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 3, të këtij neni. Plotfuqia përgatitet në gjuhën shqipe, sipas formatit zyrtar, e vulosur me vulën e thatë dhe mund të shoqërohet me përkthimin në gjuhën angleze, të vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme.

5. Në përputhje me parashikimin e nenit 5, të këtij ligji, përjashtohen nga pajisja me plotfuqi për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare Presidenti, Kryeministri, ministri i Punëve të Jashtme, ambasadori i misionit diplomatik me shtetin ose organizatën ndërkombëtare ku është akredituar.

Neni 7

Kredencialet për pjesëmarrje në konferencat ndërkombëtare

1. Përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë, që marrin pjesë në konferenca ndërkombëtare, pajisen me kredenciale, sipas formës së kërkuar nga organizatorët e konferencës. Nëse gjatë konferencës do të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare, përfaqësuesi i autorizuar për



nënshkrim pajiset me plotfuqi, sipas parashikimeve të nenit 6 të këtij ligji.

2. Kredencialet lëshohen nga ministri i Punëve të Jashtme, në bazë të autorizimit të autoritetit kompetent. Kërkesa për lëshimin e kredencialeve i drejtohet autoritetit kompetent nga ministri ose titullari i institucionit që do të marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare.

3. Autoritetet kompetente që autorizojnë lëshimin e kredencialeve janë:

a) Presidenti i Republikës, nëse delegacioni kryesohet nga Presidenti i Republikës;

b) Kryeministri, nëse delegacioni kryesohet nga Kryeministri, ose anëtarët e Këshillit të Ministrave;

c) ministri, nëse në konferencë merr pjesë përfaqësuesi i institucionit që ai drejton.

4. Ministria e Punëve të Jashtme përgatit kredencialet brenda shtatë ditëve pune nga data e marrjes së autorizimit, sipas parashikimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 3, të këtij neni. Kredencialet përgatiten në gjuhën shqipe ose angleze, sipas formatit zyrtar dhe vulosen me vulën e thatë.

Neni 8

Propozimi i projekt marrëveshjes ndërkombëtare

1. Iniciativa për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare mund të merret nga institucionet e Republikës së Shqipërisë ose të një shteti tjetër apo nga një organizatë ndërkombëtare.

2. Kur palët kanë rënë dakord për nevojën e lidhjes së një marrëveshjeje ndërkombëtare, ministria kompetente për zbatimin e marrëveshjes përgatit projektin që do t'i propozohet palës tjetër.

3. Për hartimin e projekt marrëveshjes, ministria kompetente merr mendimet e ministrive dhe institucioneve të interesuara, si dhe në çdo rast mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, kur marrëveshja ka efekt financiar, si dhe Ministrisë së Integritimit Europian, kur marrëveshja ka lidhje me *acquis* të Bashkimit Europian.

4. Kërkesa për mendim shoqërohet nga projekti në gjuhën shqipe, i certifikuar, dhe angleze, si dhe një relacion shpjegues, i cili duhet të përmbajë:

a) arsyet, qëllimin dhe objektin e marrëveshjes;
b) përparësitë dhe rezultatet e pritshme;
c) efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i saj;

ç) përputhshmërinë me Kushtetutën, legjislacionin e brendshëm dhe të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, si dhe me *acquis* të Bashkimit Europian;

d) evidentimin dhe arsyet e marrjes së masave të nevojshme ligjore që duhen miratuar për zbatimin e marrëveshjes ndërkombëtare, si dhe autoritetin përgjegjës për përgatitjen e tyre.

5. Pas marrjes së mendimeve për projekt marrëveshjen, ministria kompetente bashkërendon e reflekton në tekst propozimet dhe komentet e institucioneve të përmendura në pikën 3, të këtij neni, të cilat ia dërgon Ministrisë së Punëve të Jashtme për t'ia përcjellë në rrugë diplomatike palës tjetër.

6. Për projekt marrëveshjet e propozuara në rrugë diplomatike, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme nga një shtet tjetër ose organizatë ndërkombëtare, zbatohen parashikimet e pikave 3 deri në 5 të këtij neni.

7. Në rastet kur projekt marrëveshja trajton çështje në kompetencë të dy ose më shumë ministrive, faza përgatitore e saj drejtohet nga ministria, çështjet e së cilës përbëjnë pjesën kryesore të projekt marrëveshjes. Kur ka mosmarrëveshje për kompetencën e fazës përgatitore, Kryeministri i komunikon me shkrim ministrisë kompetente drejtimin e kësaj faze.

8. Çdo propozim i bërë në këtë fazë nga ministritë apo institucionet e përfshira analizohet nga ministria kompetente. Në rastin kur ka mosmarrëveshje për mospërfshirjen në projekt marrëveshje nga ministria kompetente të propozimeve nga ministritë ose institucionet e përfshira, Kryeministri vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

9. Marrëveshjet ndërkombëtare të huas dhe të granteve përjashtohen nga zbatimi i këtij neni.

Neni 9

Zhvillimi i negociatave

1. Negociatat për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare bëhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet përfaqësuesve të palëve ose në distancë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme. Negociatat për elemente teknike të marrëveshjes



mund të zhvillohen në distancë, ndërmjet ministrisë kompetente dhe palës tjetër, duke informuar Ministrinë e Punëve të Jashtme. Në rastet e marrëveshjeve ndërkombëtare të huas dhe granteve komunikimi ndërmjet palëve mbahet vetëm nga ministri i Financave.

2. Para zhvillimit të negociatave të drejt-përdrejta, ministria kompetente përcakton përbërjen dhe kreun e delegacionit, kohën dhe vendin e zhvillimit të negociatave. Në përbërjen e delegacionit, krahas përfaqësuesve të ministrisë / ve kompetente, mund të ketë përfaqësues të ministrive të interesuara.

3. Në përfundim të negociatave, nëse palët bien dakord, kryetarët e delegacioneve mund të para-fojnë tekstin e projekt marrëveshjes në dy ose më shumë kopje, në varësi të palëve negociuese. Për këtë qëllim, kryetarët e delegacioneve vendosin në çdo fletë të projekt marrëveshjes inicialet e tyre.

Neni 10

Miratimi në parim

1. Pas përfundimit të procesit të negocimit, projekt marrëveshja ndërkombëtare miratohet, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me propozimin ose bashkëpropozimin e ministrisë/ve kompetente.

2. Propozimi për miratimin, në parim, të marrëveshjes përmban:

- a) projektvendimin për miratimin në parim;
- b) tekstin e marrëveshjes në gjuhën e negociuar;
- c) tekstin e marrëveshjes, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të certifikuar nga Ministria e Drejtësisë;

ç) mendimet e ministrive dhe institucioneve të interesuara;

d) relacionin shpjegues, sipas pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji, përfshirë argumentet për pranimin ose jo të propozimeve e të vërejtjeve të ministrive të interesuara.

3. Nëse zbatimi i marrëveshjes lidhet me miratimin e akteve normative ose ndryshimeve të ligjeve ekzistuese, në relacion duhet të evidentohen masat ligjore që duhen ndërmarrë, rëndësia e tyre dhe autoriteti përgjegjës për përgatitjen e tyre.

Neni 11

Ndryshimet pas miratimit në parim

1. Një marrëveshje ndërkombëtare, e miratuar në parim, mund të pësojë ndryshime, me pëlqimin me shkrim të palëve nënshkruese, deri në momentin e nënshkrimit.

2. Kur ndryshimet prekin thelbin e marrëveshjes, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj, ministria kompetente i propozon Këshillit të Ministrave shfuqizimin e vendimit të mëparshëm për miratimin në parim dhe miratimin, në parim, nga e para, të marrëveshjes, sipas procedurave të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 12

Marrëveshje ndërkombëtare me shkëmbim notash

1. Marrëveshja ndërkombëtare mund të lidhet edhe me shkëmbim notash, kur palët bien dakord.

2. Kur pala shqiptare propozon lidhjen e një marrëveshjeje me shkëmbim notash, përfshin në notë tekstin e plotë të marrëveshjes në alternatin e saj në gjuhën/gjuhët për të cilën/cilat është rënë dakord me palën tjetër. Nëse pala shqiptare pranon propozimin e projekt marrëveshjes së palës tjetër, në notën ku shpreh pëlqimin, përfshin tekstin e plotë të marrëveshjes së propozuar.

3. Parashikimet në nenet 8, 9 dhe 10, të këtij ligji, zbatohen edhe për marrëveshjet me shkëmbim notash.

Neni 13

Marrëveshjet ndërinstitucionale

1. Ministrinë, institucionet qendrore e vendore, si dhe entet publike mund të lidhin marrëveshje ndërkombëtare me karakter teknik, brenda fushës së kompetencës së tyre, pasi të marrin më parë mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme e të Ministrisë së Financave, kur ka efekte financiare, si dhe të çdo ministrie apo institucioni që ka lidhje me zbatimin e marrëveshjes. Projekt marrëveshja e përcjellë për mendim shoqërohet nga një relacion shpjegues, sipas pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji, dhe nga përkthimi në gjuhën shqipe.

2. Në rastet kur projekt marrëveshja trajton çështje në kompetencë të dy ose më shumë ministrive apo institucioneve, faza përgatitore e



saj drejtohet nga ministria, çështjet e së cilës përbëjnë pjesën kryesore të marrëveshjes. Nëse ministritë nuk bien dakord, kompetencën për lidhjen e saj e përcakton Kryeministri.

3. Marrëveshjet ndërkombëtare në emër të ministrive, institucioneve qendrore e vendore, si dhe të enteve publike nuk miratohen në parim me vendim të Këshillit të Ministrave dhe mund të nënshkruhen nga:

- a) ministri përkatës;
- b) kreu i institucionit apo entit publik;
- c) çdo zyrtar i autorizuar prej tyre.

4. Pas nënshkrimit, origjinali i marrëveshjes ndërinstitucionale depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Neni 14

Forma dhe gjuha

1. Marrëveshja ndërkombëtare shtypet në dy ose më shumë kopje të njëjta, në varësi të palëve nënshkruese, në gjuhët e palëve. Marrëveshja mund të shtypet edhe në një gjuhë të tretë ose vetëm në një gjuhë të tretë, në rast se palët bien dakord. Secila kopje ka vlerën e origjinalit.

2. Ministria e Punëve të Jashtme shtyp marrëveshjen në alternatin e palës shqiptare, sipas variantit përfundimtar, për të cilën është rënë dakord mes palëve dhe të përcjellë në rrugë zyrtare, në formë shkresore e elektronike nga ministria kompetente.

3. Alternati i palës shqiptare përgatitet në letër me kornizë të kuqe dhe lidhet në një dosje të posaçme me ngjyrë të kuqe, në qendër të së cilës është vendosur emblema e Republikës së Shqipërisë, me shirit kuqez dhe, nëse bihet dakord mes palëve, vuloset me vulat përkatëse të palëve nënshkruese.

4. Në rastin e marrëveshjeve ndërinstitucionale, përgatitja e tyre për nënshkrim bëhet nga ministria ose institucioni kompetent.

KREU III

LIDHJA E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

Neni 15

Nënshkrimi

Marrëveshja ndërkombëtare nënshkruhet nga autoriteti përkatës, sipas parashikimeve të neneve 5 dhe 6, të këtij ligji, në kohën dhe në vendin e caktuar nga palët.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Një marrëveshje ndërkombëtare hyn në fuqi sipas mënyrës së parashikuar nga vetë marrëveshja dhe sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 17

Ratifikimi

1. Ratifikimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj.

2. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, propozimin për ratifikimin e marrëveshjes, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:

- a) projektligji për ratifikim;
- b) projektvendimi për propozimin e projektligjit;
- c) vendimi i miratimit në parim;
- ç) tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe;
- d) relacioni shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji;
- dh) mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit.

3. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për ratifikim Kuvendit.

Neni 18

Aderimi/pranimi/miratimi

1. Aderimi/pranimi/miratimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare, e cila nuk është nënshkruar më parë prej saj, sipas parashikimeve të vetë marrëveshjes.

2. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave propozimin për aderimin/pranimin/miratimin e marrëveshjes ndërkombëtare, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:



- a) projektligjin për aderim/pranim/miratim;
- b) projektvendimin për propozimin e projektligjit;
- c) tekstin e marrëveshjes në gjuhën e hartuar, të shoqëruar nga përkthimi në gjuhën shqipe, i certifikuar;
- ç) mendimet e ministrive e të institucioneve të interesuara, si dhe, në çdo rast, të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, kur marrëveshja ka efekte financiare, si dhe Ministrisë së Integritetit Europian, kur marrëveshja ka lidhje me *acquis* të Bashkimit Europian;
- d) relacionin shpjegues, sipas pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji, përfshirë argumentet për pranimin ose jo të propozimeve e të vërejtjeve të ministrive ose institucioneve të interesuara.

3. Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.

Neni 19

Miratimi pas nënshkrimit

1. Marrëveshjet ndërkombëtare që, pas nënshkrimit, nuk ratifikohen, miratohen nga Këshilli i Ministrave, sipas procedurave të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.
2. Marrëveshjet ndërkombëtare financiare të grantit, që nuk sjellin detyrime shtesë për Buxhetin e Shtetit dhe që nuk përcaktojnë përjashtime nga ligje të tjera, pas nënshkrimit, i nënshtrohen miratimit nga Këshilli i Ministrave.
3. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, propozimin për miratimin e marrëveshjes, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:
 - a) projektvendimin për miratim;
 - b) vendimin e miratimit në parim;
 - c) tekstet marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze, ose përkthimin e certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe;
 - ç) relacionin shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji;
 - d) mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektvendimit.

Neni 20

Hyrja në fuqi me nënshkrim

1. Një marrëveshje ndërkombëtare, që nuk i nënshtrohet ratifikimit /aderimit / pranimit / miratimit, ose miratimit pas nënshkrimit, hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.
2. Hyjnë në fuqi me nënshkrim kryesisht marrëveshjet me karakter teknik, brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë/ve kompetente dhe kur palët bien dakord.

Neni 21

Zbatimi i përkohshëm

1. Një marrëveshje ndërkombëtare mund të zbatohet përkohësisht, në përputhje me dispozitat e saj, deri në momentin e hyrjes në fuqi. Zbatimi i përkohshëm mund të bëhet kur pasojat e këtij zbatimi nuk kanë të bëjnë me ushtrimin e sovranitetit, integritetin territorial dhe nuk sjell efekte financiare për Republikën e Shqipërisë.
2. Zbatimi i përkohshëm mund të ndërpritet, sipas parashikimeve të marrëveshjes, me iniciativën e ministrisë kompetente pas komunikimit zyrtar të saj me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Neni 22

Marrëveshjet zbatuese

1. Në zbatim të një marrëveshjeje ndërkombëtare mund të lidhen marrëveshje zbatuese kur vetë marrëveshja bazë e parashikon këtë. Marrëveshjet zbatuese mund të lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave ose ministrisë apo institucionit kompetent.
2. Procedurat e lidhjes së marrëveshjes zbatuese janë të njëjta me procedurat e parashikuara në nenet 8, 9, 10, 11 e 15 të këtij ligji.
3. Kur marrëveshja bazë i është nënshtuar procedurës së ratifikimit, ministria kompetente përcakton nëse marrëveshja në zbatim të saj mund të hyjë në fuqi me nënshkrim, me miratimin pas nënshkrimit nga Këshilli i Ministrave ose me ratifikim.
4. Kur marrëveshja zbatuese lidhet në emër të ministrisë ose institucionit kompetent, respektohen procedurat e parashikuara në nenin 13 të këtij ligji.



Neni 23

Ndryshimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Një marrëveshje ndërkombëtare, pas hyrjes në fuqi, mund të ndryshohet, në përputhje me parashikimet e vetë marrëveshjes dhe dispozitave të këtij ligji.

2. Procedurat për ndryshimin e marrëveshjes ndërkombëtare bëhen sipas parashikimeve të këtij ligji, në lidhje me propozimin, negociimin, miratimin në parim, nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.

3. Ndryshimet e marrëveshjes ndërkombëtare, të cilat nuk kanë si objekt çështjet e parashikuara në pikën 1, të nenit 121, të Kushtetutës, dhe nuk ndryshojnë kushtet financiare të saj, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

DEPOZITIMI DHE ZBATIMI I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

Neni 24

Depozitimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Ministria ose institucioni kompetent, pas nënshkrimit të çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, depoziton dosjen origjinale të marrëveshjes së nënshkruar ose kopjen e certifikuar të origjinalit nga depozitari në Ministrinë e Punëve të Jashtme, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit.

2. Kur marrëveshja ndërkombëtare është lidhur vetëm në një gjuhë të huaj, të rënë dakord mes palëve, ministria ose institucioni kompetent depoziton në Ministrinë e Punëve të Jashtme, krahas origjinalit të marrëveshjes, edhe përkthimin në gjuhën shqipe, të certifikuar.

3. Ministria e Punëve të Jashtme kryen rolin e depozitarit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, kur marrëveshja përcakton Republikën e Shqipërisë në këtë funksion.

Neni 25

Zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Marrëveshjet ndërkombëtare zbatohen nga ministritë apo institucionet e Republikës së Shqipërisë, që janë kompetente për fushën e marrëveshjes, ose nga institucionet e përcaktuara në marrëveshje.

2. Ministritë apo institucionet kompetente informojnë çdo gjashtë muaj Këshillin e

Ministrave dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për zbatimin dhe vlefshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare.

3. Ministritë dhe institucionet kompetente, sipas fushave, informojnë periodikisht Ministrinë e Punëve të Jashtme, në kuadrin e hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

4. Ministria e Punëve të Jashtme drejton procesin e hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve për të drejtat e njeriut, të cilat i paraqet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

KREU V

REZERVA, DEKLARATA, DENONCIMI DHE PEZULLIMI I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

Neni 26

Rezervat

1. Republika e Shqipërisë mund të paraqesë një rezervë të pajtueshme me objektin dhe qëllimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare në kohën e nënshkrimit, ratifikimit / aderimit / pranimit/miratimit të saj, sipas parashikimeve të marrëveshjes.

2. Rezerva hartohet nga ministria kompetente dhe mund të përfshihet në projektaktin e miratimit në parim, ratifikimit / aderimit / pranimit/miratimit të marrëveshjes.

3. Të drejtën për të bërë rezervë për një marrëveshje ndërkombëtare e ka edhe Kuvendi në momentin e ratifikimit /aderimit /pranimit /miratimit të marrëveshjes.

4. Në rastin kur rezerva bëhet pas hyrjes në fuqi të aktit të miratimit të marrëveshjes, miratimi i rezervës bëhet me ligj.

5. Republika e Shqipërisë mund të tërheqë një rezervë të bërë prej saj ndaj një marrëveshjeje, sipas së njëjtës procedurë për propozimin e saj.

Neni 27

Pranimi, kundërshtimi i rezervave dhe tërheqja e kundërshtimit

1. Republika e Shqipërisë mund të pranojë, të kundërshtojë ose të tërheqë kundërshtimin e rezervave të një pale tjetër në një marrëveshje ndërkombëtare.



2. Pranimi, kundërshtimi dhe tërheqja e kundërshtimit të rezervave bëhet me ligj të propozuar nga Këshilli i Ministrave. Iniciativa për miratimin e pranimi, kundërshtimi dhe tërheqja e kundërshtimit të rezervave merret nga ministria kompetente.

Neni 28 Deklaratat

1. Republika e Shqipërisë mund të bëjë deklaratë për interpretimin dhe pranimin e dispozitave të veçanta të një marrëveshjeje ndërkombëtare.

2. Deklarata propozohet nga ministria kompetente, pas marrjes së mendimeve të ministrive dhe institucioneve të interesuara, përfshirë Ministrinë e Punëve të Jashtme, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Deklaratat paraqiten nga Ministria e Punëve të Jashtme në kohën e dorëzimit të instrumentit të ratifikimit/aderimit/pranimi/miratimit ose në një kohë të mëvonshme, sipas parashikimeve të marrëveshjes.

4. Tërheqja ose ndryshimi i deklaratës bëhet sipas së njëjtës procedurë, të parashikuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 29 Denoncimi

1. Republika e Shqipërisë mund të denoncojë një marrëveshje ndërkombëtare, sipas parashikimeve të marrëveshjes dhe të këtij ligji.

2. Denoncimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për marrëveshjet e ratifikuara prej tij ose Këshilli i Ministrave për marrëveshjet e miratuara prej tij pas nënshkrimit apo që kanë hyrë në fuqi me nënshkrim.

3. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave propozimin për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:

a) projektligjin ose projektvendimin për denoncimin e marrëveshjes;

b) projektvendimin për propozimin e projektligjit;

c) mendimet e ministrive e të institucioneve të interesuara e të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, kur marrëveshja ka efekte financiare, si dhe të

Ministrisë së Integritit European, kur marrëveshja ka lidhje me *acquis* të Bashkimit European;

ç) relacionin shpjegues, sipas pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji, përfshirë argumentet për pranimin ose jo të propozimeve e të vërejtjeve të ministrive ose institucioneve të interesuara.

Neni 30 Pezullimi

1. Republika e Shqipërisë mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare sipas parashikimeve të marrëveshjes dhe këtij ligji.

2. Pezullimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për marrëveshjet e ratifikuara prej tij ose Këshilli i Ministrave për marrëveshjet e miratuara prej tij pas nënshkrimit apo që kanë hyrë në fuqi me nënshkrim.

3. Propozimi për pezullimin e zbatimit të marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga ministria kompetente dhe shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

a) projektligji ose projektvendimi për pezullimin e marrëveshjes;

b) mendimet e ministrive e të institucioneve të interesuara e të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, kur marrëveshja ka efekte financiare, si dhe të Ministrisë së Integritit European, kur marrëveshja ka lidhje me *acquis* të Bashkimit European;

c) relacioni shpjegues sipas pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji, përfshirë argumentet për pranimin ose jo të propozimeve e të vërejtjeve të ministrive ose institucioneve të interesuara.

KREU VI NJOFTIMET DHE INSTRUMENTET

Neni 31 Njoftimet

1. Këshilli i Ministrave i përcjell menjëherë Ministrisë së Punëve të Jashtme dekretin e Presidentit të Republikës për miratimin e çdo ligji për ratifikimin /aderimin /pranimin /miratimin /denoncimin /pezullimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin pas nënshkrimit të saj.

2. Ministria e Punëve të Jashtme, pas botimit në Fletoren Zyrtare të akteve të parashikuara në pikën



1, të këtij neni, bën çdo njoftim, sipas parashikimit të marrëveshjes për hyrjen në fuqi, pezullimin, denoncimin dhe shfuqizimin e marrëveshjes.

3. Në rastin e marrëveshjeve të lidhura me institucionet financiare ndërkombëtare, njoftimet e përmendura në këtë pikë bëhen nga ministri i Financave.

Neni 32

**Instrumentet e
ratifikimit/aderimit/pranimit/miratimit
/denoncimit**

1. Ministria e Punëve të Jashtme harton instrumentet e ratifikimit /aderimit /pranimit /miratimit /denoncimit të marrëveshjes ndërkombëtare dhe i shkëmben ose depoziton sipas parashikimeve të marrëveshjes.

2. Instrumenti i ratifikimit /aderimit /pranimit /miratimit/denoncimit përgatitet në gjuhën shqipe, sipas formatit zyrtar, i vulosur me vulën e thatë dhe shoqërohet me përkthimin në gjuhën angleze, të vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme. Ministri i Punëve të Jashtme nënshkruan instrumentin e ratifikimit/aderimit/pranimit/miratimit/denoncimit.

3. Instrumenti i ratifikimit /aderimit /pranimit /miratimit/denoncimit përmban titullin e marrëveshjes ndërkombëtare, datën dhe vendin e nënshkrimit të saj dhe instrumentit. Në instrumentin e ratifikimit /aderimit /pranimit /miratimit përfshihen rezervat dhe deklaratat e mundshme për dispozita të veçanta të marrëveshjes.

KREU VII

**PUBLIKIMI, REGJISTRIMI, KORRIGJIMI
DHE INTERPRETIMI I MARRËVESHJEVE
NDËRKOMBËTARE**

Neni 33

Publikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Ligji i ratifikimit /aderimit /pranimit /miratimit /denoncimit ose vendimi i miratimit pas nënshkrimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, së bashku me tekstin e marrëveshjes në gjuhën shqipe dhe në gjuhën tjetër të huaj të nënshkruar, botohen në Fletoren Zyrtare.

2. Me qëllim publikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, sipas aktit të miratimit, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave i përcjellin Qendrës së Botimeve Zyrtare një kopje të printuar dhe një

kopje elektronike në gjuhën shqipe dhe në gjuhën tjetër të huaj të nënshkruar ose kopje të përkthimit në gjuhën shqipe, të certifikuar, kur marrëveshja nuk është nënshkruar në gjuhën shqipe.

3. Ministria e Punëve të Jashtme i përcjell për botim Qendrës së Botimeve Zyrtare njoftimet për hyrjen në fuqi, pezullimin, denoncimin dhe shfuqizimin e marrëveshjes ndërkombëtare.

Neni 34

Regjistrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

Ministria e Punëve të Jashtme bën regjistrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare pranë Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së ose organizatave përkatëse pas hyrjes së tyre në fuqi, sipas marrëveshjes së palëve.

Neni 35

**Korrigjimi i gabimeve në marrëveshjen
ndërkombëtare**

1. Në rast korrigjimi të gabimeve në tekstin e një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, Ministria e Punëve të Jashtme, pas rënies dakord të palëve nënshkruese, bën korrigjimin e gabimit.

2. Ministria e Punëve të Jashtme njofton ministrinë kompetente dhe Qendrën e Botimeve Zyrtare për bërjen e korrigjimit të gabimit.

3. Çdo korrigjim gabimi në marrëveshjen ndërkombëtare botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 36

**Interpretimi i marrëveshjeve
ndërkombëtare**

1. Një marrëveshje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, interpretohet në mirëbesim, në përputhje me kuptimin e termave të marrëveshjes në kontekstin e tyre, nën dritën e objektit dhe qëllimit të marrëveshjes.

2. Kur institucioni zbatues i një marrëveshjeje ndërkombëtare nuk arrin të bjerë dakord me palën tjetër për interpretimin e marrëveshjes, ai njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme për mosmarrëveshjen, në lidhje me interpretimin.

3. Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe subjekteve të tjera të lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, zgjidhen me negociata të drejtpërdrejta apo mjete të



tjera të zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve të pranuar nga e drejta ndërkombëtare.

4. Ministria e Punëve të Jashtme njofton institucionin zbatues për rezultatet e negociatave apo për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me metodat paqësore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

KREU VIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Dispozita të fundit dhe kalimtare

Çështjet që nuk janë rregulluar në këtë ligj do të trajtohen nga normat e së drejtës ndërkombëtare, të detyrueshme në Republikën e Shqipërisë.

Neni 38

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8371, datë 9.8.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, shfuqizohet.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.4.2016

KRYETARI
Ilir Meta

LIGJ Nr. 65/2016

PËR NDËRMARRJET SOCIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale dhe përcakton

kushtet e kriteret që një subjekt duhet të plotësojë që të përfitojë statusin e ndërmarrjes sociale.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka si qëllim të rregullojë veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale, me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabel, nëpërmjet:

a) punësimit, në kuadër të njohjes së të drejtës themelore të individit për të pasur burime të mjaftueshme jetese, në përputhje me dinjitetin njerëzor;

b) ofrimit të mundësive të punësimit për personat, të cilëve moshë, shëndeti dhe gjendja familjare nuk u lejon një disponueshmëri aktive në tregun e punës;

c) ofrimit të mallrave dhe shërbimeve në forma të larmishme dhe me cilësi të mirë, duke siguruar mundësi të përshtatshme dhe të arritshme për individët me nevoja të veçanta, si dhe duke shënuar një hap thelbësor drejt barazisë gjinore, pasi këto shërbime lehtësojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës;

ç) integritit ekonomik e social të grupeve në nevojë, duke nxitur frymën e përgjegjshmërisë, solidaritetit dhe kohezionit shoqëror në komunitet.

Neni 3

Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet për personat juridikë që ushtrojnë veprimtarinë si ndërmarrje sociale, duke krijuar kushte të përshtatshme për punësim të individëve të pafavorizuar në tregun e punës.

Neni 4

Parimet

Organizimi dhe funksionimi i ndërmarrjeve sociale bazohet në parimet e gjithëpranuar, në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë në dobi të komunitetit, dhe, veçanërisht, në parimin e:

a) transparencës: ndërmarrjet sociale dhe organet e tyre vendimmarrëse veprojnë në mënyrë transparente dhe të parashikueshme, duke promovuar pjesëmarrjen dhe llogaridhënien;

b) qëndrueshmërisë: themeluesit e ndërmarrjeve sociale marrin përsipër rrezikun e qëndrueshmërisë financiare dhe planifikojnë me



maturi realizimin e të ardhurave, në bashkëpunim me anëtarët dhe punonjësit;

c) autonomisë dhe llogaridhënies: ndërmarrjet sociale e ushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në vendimet e organeve drejtuese, të cilat i marrin vendimet për organizimin, funksionimin dhe administrimin e subjektit në mënyrë autonome dhe pa u ndikuar nga organet shtetërore, edhe pse përfitojnë subvencione publike. Organet publike kanë të drejtë të mbikëqyrin mënyrën e përdorimit të fondeve që ndërmarrjet sociale përfitojnë nga subvencionet publike;

ç) dimensionit kolektiv: ndërmarrjet sociale ruajnë dhe promovojnë dimensionin kolektiv, duke përfshirë në anëtarësi dhe vendimmarrje aktorë të tjerë, të tillë si punonjësit, vullnetarët, përdoruesit e shërbimeve dhe blerësit e mallrave, organet e qeverisjes vendore dhe çdo aktor tjetër të interesuar për të kontribuar në realizimin e një projekti të zhvillimit lokal;

d) efektivitetit: ndërmarrjet sociale planifikojnë dhe përdorin me efektivitet burimet financiare, duke siguruar përfitimin maksimal social të mundshëm.

Neni 5

Promovimi i ndërmarrjeve sociale nga shteti

1. Ndërmarrjet sociale promovohen me anë të zbatimit të masave mbështetëse, të cilat përfshijnë masa financiare e të tjera, dhe nëpërmjet zhvillimit të sistemit të informimit e edukimit për ndërmarrjet sociale.

2. Sistemi i informimit dhe edukimit të sipërmarrjes sociale përfshin:

a) ofrimin e shërbimeve, në mbështetje të krijimit dhe funksionimit të ndërmarrjeve sociale, përfshirë këshillimin për përgatitjen e dokumentacionit për themelimin e ndërmarrjes sociale;

b) prezantimin e ideve të reja, që rezultojnë nga analizimi i tregut;

c) identifikimin e mundësive për të ofruar shërbime publike.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ngarkohet për hartimin e politikave të promovimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve sociale.

Neni 6

Roli i njërive të vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështetin dhe zbatojnë politikat e zhvillimit të ndërmarrjeve sociale në territoret brenda juridiksionit të tyre.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore stimulojnë pjesëmarrjen e ndërmarrjeve sociale në procedurat e prokurimit publik, sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

KREU II KRITERET

Neni 7

Kriteret

Një subjekt për të mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale duhet të plotësojë një minimum kriteresh të natyrës ekonomike dhe sociale.

Neni 8

Kriteret ekonomike

Për të mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale duhet të plotësohen këto kriteret ekonomike:

1. Ndërmarrja sociale duhet të ushtrojë në mënyrë të vazhdueshme një veprimtari në fushën e prodhimit të mallrave dhe/ose ofrimin të shërbimeve.

2. Të paktën, 20 për qind e të ardhurave, pas vitit të dytë të aktivitetit dhe, të paktën, 30 për qind e të ardhurave, pas vitit të tretë e në vijim të aktivitetit, duhet të realizohen nga veprimtaritë e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji.

3. Në veprimtarinë e saj ndërmarrja sociale, përveç kontributit të vullnetarëve, duhet të përfshijë domosdoshmërisht edhe, të paktën, 3 punonjës me pagesë.

4. Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria ekonomike e ndërmarrjeve sociale i shërbejnë zgjerimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së tyre.

Neni 9

Kriteret sociale

Për të mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale duhet të plotësohen këto kriteret sociale:

1. Ndërmarrja sociale synon nxitjen e objektivave sociale në një fushë veprimtarie të mirëpërcaktuar.

2. Të paktën, 30 për qind e punonjësve të punësuar në ndërmarrjen sociale duhet t'i



përkasin kategorisë së grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike, të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 10

Fusha e veprimtarisë

1. Ndërmarrjet sociale e ushtrojnë veprimtarinë në këto fusha:

- a) shërbime shoqërore;
- b) ndërmjetësim për punësim;
- c) punësim të të rinjve;
- ç) mbrojtje dhe promovim i shëndetit;
- d) shërbime në arsim;
- dh) mbrojtje mjedisore;
- e) promovim i turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore;
- ë) veprimtari sportive, me qëllim argëtimin dhe socializimin;
- f) promovim i zhvillimit të komuniteteve lokale.

2. Këshilli i Ministrave miraton listën e veprimtarive konkrete që ushtrojnë ndërmarrjet sociale, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 11

Grupet e pafavorizuara

1. Ndërmarrjet sociale kontribuojnë në mbrojtjen shoqërore dhe mbështetjen e grupeve të pafavorizuara, nëpërmjet punësimit të tyre dhe ofrimit të shërbimeve për to.

2. Në grupet e pafavorizuara përfshihen grupet me probleme të varfërisë ekstreme, përjashtimit social për shkak të diskriminimit, papunësisë afatgjatë, vështirësive për shkak të të qenit i proceduar penalisht apo nën varësinë e drogës dhe alkoolit, dhe personat e shpërngulur.

3. Kategoritë konkrete të grupeve të pafavorizuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III STATUSI

Neni 12

Forma juridike

1. Ndërmarrjet sociale janë organizata jofitimprurëse, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.

2. Pas përfitimit të statusit të ndërmarrjes sociale është i detyrueshëm përdorimi i emërimit

“Ndërmarrje sociale” në krah të emrit të organizatës.

3. Ndalohet përdorimi i emërimit “Ndërmarrje sociale” nga çdo subjekt që nuk mban statusin, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

4. Ndërmarrjet sociale mund të vendosin të formojnë organizata të ndërmarrjeve sociale.

Neni 13

Njohja ose refuzimi i statusit

1. Njohja e statusit të ndërmarrjes sociale, për një subjekt, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, pas verifikimit të dokumenteve.

2. Aplikimi për përfitimin e statusit bëhet pas regjistrimit të subjektit në autoritetin kompetent dhe marrjes së licencës, në rast se ndërmarrjet sociale ushtrojnë veprimtari për të cilat nevojitet licencë.

3. Procedurat dhe dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

4. Statusi i ndërmarrjes sociale refuzohet në rastet kur subjekti:

- a) nuk përmbush kushtet ose nuk ka paraqitur dokumentacionin, sipas kërkesave të parashikuara në udhëzimin e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni;
- b) ka paraqitur informacion apo dokumentacion të rremë.

5. Në çdo rast, urdhri i ministrit për njohjen ose refuzimin e statusit lëshohet brenda 30 ditëve nga data e aplikimit.

Neni 14

Humbja e statusit

1. Statusi i ndërmarrjes sociale humbet nëse:

- a) ndërmarrja sociale, me iniciativën e vet, i drejtohet me kërkesë të motivuar ministrit përgjegjës për çështjet sociale;
- b) vërehen parregullsi të rëndësishme dhe/ose të përsëritura në veprimtarinë e ndërmarrjes sociale;

c) statusi është fituar nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër, që përbën veprë penale;

ç) ndërmarrja sociale ka ndërprerë veprimtarinë për një periudhë më të gjatë se 6 muaj ose është shpërndarë.



2. Procedurat dhe dokumentacioni i nevojshëm për ndalimin e veprimtarisë së një ndërmarrjeje sociale dhe heqja e statusit të ndërmarrjes sociale përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

3. Humbja e statusit shpallet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

4. Brenda 3 ditëve, urdhri i ministrit për heqjen e statusit depozitohet në regjistrin kombëtar të ndërmarrjeve sociale, duke sjellë çregjistrimin e saj nga ky regjistër.

5. Në rastet e humbjes së statusit të ndërmarrjes sociale, pas likuidimit të kreditorëve, pasuria e krijuar gjatë mbajtjes së statusit duhet të përdoret për interes publik ose duhet t'u kalojë ndërmarrjeve të tjera sociale.

Neni 15

Regjistri i ndërmarrjeve sociale

1. Ndërmarrjet sociale regjistrohen si të tilla në regjistrin e mbajtur nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

2. Krijimi i regjistrit të ndërmarrjeve sociale, në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, dhe rregullat e hollësishme për formatin e përmbajtjen e tij përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

3. Regjistri i ndërmarrjeve sociale bëhet publik sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I NDËRMARRJEVE SOCIALE

Neni 16

Funksionimi

1. Veprimtaria e ndërmarrjeve sociale drejtohet nga organet vendimmarrëse dhe organet ekzekutive, duke përfshirë në vendimmarrje edhe aktorë të tjerë, të tillë si punonjësit, vullnetarët, përdoruesit e shërbimeve dhe blerësit e mallrave, organet e qeverisjes vendore dhe çdo aktor tjetër të interesuar.

2. Ministri përgjegjës për çështjet sociale miraton rregulloren tip të funksionimit të ndërmarrjeve sociale.

Neni 17

Mosshpërndarja e fitimit

1. Në rast se ndërmarrjet sociale realizojnë fitim nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë

ekonomike, ato duhet të tatohen për fitimin e realizuar, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

2. Ndërmarrja sociale i përdor fitimet për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së saj.

3. Shpërndarja e çdo lloj fitimi, qoftë dhe në formë indirekte, në favor të anëtarëve, punonjësve apo bashkëpunëtorëve të ndërmarrjes sociale është e ndaluar.

4. Konsiderohen fitime indirekte:

a) shpërblimet e anëtarëve, drejtuesve dhe bashkëpunëtorëve, në vlera më të mëdha se ato të parashikuara në ndërmarrjet që veprojnë në sektorë dhe kushte të njëjta ose të ngjashme, kur ky shpërblim i kalon me më shumë se 20 për qind shpërblimet e marra si referencë;

b) pagat e punonjësve, në çfarëdo pozicioni, i kalojnë me më shumë se 20 për qind pagat e parashikuara nga kontratat apo marrëveshjet për punët e veçanta, në sektorë të ngjashëm, përveç rasteve kur përfitimi lidhet me punë profesionale specifike, që kryhet për një periudhë të caktuar kohe.

Neni 18

Të drejtat e punonjësve

1. Çdo punonjës ka të drejtë për mbrojtje shoqërore të përshtatshme, cilido qoftë statusi i tij dhe pavarësisht nga madhësia e ndërmarrjes sociale, në të cilën ai është i punësuar.

2. Punonjësve të ndërmarrjes sociale nuk mund t'u caktohet një trajtim ekonomik dhe ligjor më pak i favorshëm se ai i parashikuar nga kontratat e punës ose marrëveshjet kolektive të zbatueshme, në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

3. Punonjësit e ndërmarrjes sociale, pavarësisht pozicionit të tyre, kanë të drejtën e informimit, të dhënies së mendimit dhe të pjesëmarrjes në vendimet për drejtimit strategjike.

4. Kufijtë dhe mënyrat e realizimit të këtyre të drejtave përcaktohen në rregulloret e brendshme të ndërmarrjeve sociale ose në marrëveshjet e lidhura ndërmjet organeve të administrimit të ndërmarrjes sociale dhe punonjësve apo përfaqësuesve të punonjësve.

Neni 19

Pjesëmarrja kolektive në vendimmarrje

1. Çdo person fizik apo juridik, vendas ose i huaj, ka të drejtë që të jetë anëtar i ndërmarrjes



sociale, si dhe të marrë pjesë në organet drejtuese ose në personelin administrativ të saj.

2. Rregullorja e funksionimit të ndërmarrjes sociale duhet të parashikojë, ndër të tjera, edhe forma të pjesëmarrjes së punonjësve apo aktorëve të tjerë të interesuar, në vendimet e planifikimit strategjik të ndërmarrjes.

3. Pjesëmarrja realizohet edhe nëpërmjet dhënies së informacioneve të nevojshme, të cilat u mundësojnë punonjësve dhe përfituesve të veprimtarive të japin mendimin dhe kontributin e tyre në marrjen e vendimeve që lidhen me drejtimin e përgjithshëm, veçanërisht për çështjet që kanë të bëjnë me kushtet e punës, si edhe me sigurimin e cilësisë së mallrave e shërbimeve të ofruara nga ndërmarrja.

Neni 20

Anëtarët vullnetarë

1. Anëtarë të ndërmarrjes sociale mund të jenë dhe personat që kontribuojnë me punën e tyre në mënyrë vullnetare, sipas legjislacionit në fuqi për vullnetarizmin.

2. Aktet e themelimit dhe statutet e ndërmarrjeve sociale mund të parashikojnë dhënien e statusit të anëtarit edhe punonjësve apo personave që ofrojnë shërbime vullnetare.

3. Anëtarët vullnetarë regjistrohen, rregullisht, në regjistrin e ndërmarrjeve sociale dhe numri i tyre nuk mund ta kalojë gjysmën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

4. Për anëtarët vullnetarë nuk zbatohen kontratat kolektive dhe dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me përjashtim të dispozitave për mbrojtjen nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.

5. Anëtarët vullnetarë nuk paguhet, por mund të marrin vetëm rimbursim për shpenzimet e kryera e të dokumentuara, sipas rregullave të përcaktuara nga ndërmarrja sociale për anëtarët e tjerë.

KREU V KONTROLLI I NDËRMARRJEVE SOCIALE

Neni 21

Detyrimi për raportim

1. Ndërmarrjet sociale paraqesin pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale raporte periodike për veprimtaritë e ushtruara në favor të

interesit të përgjithshëm kolektiv dhe kategoritë e personave të punësuar.

2. Format, afatet dhe mënyrat e raportimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 22

Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, nëpërmjet strukturave të veta, ushtron kontrollin, me qëllim që të verifikohet respektimi i dispozitave të këtij ligji nga ana e ndërmarrjeve sociale.

2. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, në varësi të natyrës së ndërmarrjes sociale dhe veprimtarive të ushtruara prej saj, gjatë ushtrimit të kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale, koordinon punën me inspektorate të institucioneve të tjera shtetërore.

3. Procedura e kryerjes së kontrollit, nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, bashkërendimi i punës me inspektoratet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve, gjatë kontrollit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) në rast se gjatë veprimtarisë së tij subjekti shkel një nga kriteret ekonomike të parashikuara në nenin 8, të këtij ligji, ai dënohet me gjobë nga 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

b) në rast se gjatë veprimtarisë së tij subjekti shkel një nga kriteret sociale të parashikuara në nenin 9, të këtij ligji, ai dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë;

c) përdorimi i emërimit “Ndërmarrje sociale” në kundërshtim me përcaktimin e nenit 12, pika 3, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë.

2. Organi kompetent për dënimin e shkeljes administrative është organi që e ka konstatuar.



KREU VI
BURIMET E FINANCIMIT DHE
MBËSHTETJA SHETËRORE

Neni 24

Burimet e financimit

Ndërmarrjet sociale e ushtrojnë veprimtarinë e tyre me mjete financiare që mund t'i sigurojnë nga këto burime:

- a) të ardhura të realizuara nga shitja e mallrave dhe tarifave të shërbimeve;
- b) subvencione publike, të lidhura me misionet e tyre të mbështetjes sociale dhe punësimit;
- c) donacione private;
- ç) të ardhura të tjera, të njohura nga legjislacioni në fuqi.

Neni 25

Regjimi fiskal

Ndërmarrjet sociale i nënshtrohen zbatimit të legjislacionit fiskal, për kategorinë e tatimpaguesve së cilës ato i përkasin.

Neni 26

Format e mbështetjes

1. Ndërmarrjet sociale mbështeten nga shteti, nëpërmjet subvencionimit të ndërmarrjeve ose punonjësve në këto subjekte.

2. Format e mbështetjes, nëpërmjet subvencionit, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas vlerësimit të bërë nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

3. Format e tjera të mbështetjes dhe lehtësive rregullohen nga legjislacioni për ndihmën shtetërore, ai tatimor dhe ai për organizatat jofitimprurëse.

Neni 27

Pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik

1. Autoritetet kontraktuese u japin të drejtën ndërmarrjeve sociale që të marrin pjesë në procedurat për dhënien e kontratave publike për shërbimet shëndetësore, sociale dhe kulturore.

2. Në çdo rast, procedurat e dhënies së këtyre kontratave duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe të respektojnë parimet e përgjithshme të prokurimeve publike.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 28

Ankimi dhe ekzekutimi i masave administrative

1. Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektues, të përcaktuar në këtë ligj, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin, ndërsa procedurat e konstatimit, shqyrtimit, vendosjes, ankimit dhe ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

2. Procedurat e shqyrtimit të dhënies së masave administrative, si dhe ankimit të vendimit administrativ bëhen në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ bëhet ankimi në gjykatën administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Neni 29

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pika 2; 11, pika 3; 22, pika 3; dhe 26, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë urdhrat dhe udhëzimet në zbatim të neneve 13, pika 3; 14, pika 2; 15, pika 2; 16, pika 2; dhe 21, pika 2, të këtij ligji.

Neni 30

Rregullime plotësuese

Për çështjet që nuk janë të rregulluara në mënyrë të shprehur në këtë ligj do të zbatohen dispozitat e ligjit për organizatat jofitimprurëse.



Neni 31

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.6.2016

Shpallur me dekretin nr. 9648, datë 21.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 66/2016

PËR SHËRBIMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore dhe kriteret që garantojnë të drejtën e themelimit dhe të drejtën e ushtrimit të aktivitetit për ofruesit e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjitha shërbimet e ofruara në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të:

a) shërbimeve joekonomike, me interes të përgjithshëm;

b) shërbimeve financiare, si shërbimet bankare, kreditimi, sigurimi e risigurimi, pensionet profesionale e personale, letrat me vlerë, fondet e investimeve, pagesat dhe këshillimi për investimet, përfshirë shërbimet financiare të

listuara në shkronjën “B” të aneksit IV të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri;

c) shërbimeve e rrjeteve të komunikimit elektronik, si dhe objekteve të lidhura me to, në lidhje me çështjet që mbulon ligji për komunikimet elektronike;

ç) shërbimeve në fushën e transportit, përfshirë transportin rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror;

d) shërbimeve të agjencive të punësimit të përkohshëm;

dh) shërbimeve shëndetësore e farmaceutike, të ofruara me qëllim terapeutik, nëpërmjet strukturave të kujdesit shëndetësor apo jo, dhe pavarësisht mënyrës së organizimit e financimit të tyre apo faktit nëse janë publike apo private;

e) shërbimeve audiovizive, përfshirë edhe shërbimet kinematografike, pavarësisht mënyrës së prodhimit, shpërndarjes e transmetimit, si edhe transmetimet radiofonike e çdo shërbim tjetër, që jepet në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në bazë të legjislacionit që rregullon këtë veprimtari në vendin tonë;

ë) lojërave të fatit;

f) veprimtarive që lidhen me ushtrimin e autoritetit zyrtar;

g) shërbimeve sociale që u ofrohen individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë, me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente ose kronike, të ofruara nga shteti ose subjekte jopublike, të licencuara nga shteti;

gj) strehimit social;

h) taksave kombëtare ose vendore;

i) shërbimeve private të sigurisë fizike;

j) shërbimeve të ofruara nga noterët apo përmbaruesit, të emëruar me një akt të autoritetit kompetent.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Arsye madhore të lidhura me interesin publik” janë politika publike, sigurimi/mbrojtja publike, siguria publike, shëndeti publik, ruajtja e ekuilibrit financiar të sistemit të sigurimeve

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 12 dhjetor 2006, “Për shërbimet në tregun e brendshëm” Celex : 32006L0123, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L 376, datë 27.12.2006, faqe 36-68.



shoqërore, mbrojtja e konsumatorëve, përfituesve të shërbimeve dhe punonjësve, korrektësia, drejtësia në transaksionet tregtare, lufta ndaj mashtrimeve tregtare, krimi ekonomik, mbrojtja e mjedisit dhe e ambientit qytetës, shëndeti i kafshëve, pronësia intelektuale, ruajtja e trashëgimisë historike e kulturore kombëtare, objektivat e politikës sociale dhe objektivat e politikës kulturore.

2. “Autoritet kompetent” është çdo organ ose autoritet që ka rol mbikëqyrës apo rregullator në një veprimtari shërbimi, në mënyrë të veçantë organet administrative, përfshirë gjykatat administrative, organet profesionale dhe shoqatat apo organizata të tjera profesionale, të cilat rregullojnë, në mënyrë kolektive, ofrimin ose përfitimin e një shërbimi apo ushtrimin e veprimeve të tjera të lidhura me të.

3. “Autoriteti përgjegjës” është autoriteti që mbulon çështjet dhe harton politikat e nevojshme për një sektor të caktuar.

4. “Komunikim tregtar” është çdo formë komunikimi, e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, që ka për qëllim të promovojë mallrat, shërbimet apo imazhin e një sipërmarrjeje, organizate ose personi të angazhuar në një veprimtari tregtare, industriale, zeytare, apo në ushtrimin e një profesioni të rregulluar. Nuk përbëjnë komunikim tregtar, në kuptim të këtij ligji:

a) informacioni që mundëson aksesin e drejtpërdrejtë në veprimtarinë e një sipërmarrjeje, organizate apo personi, si emri i *domain*-it në internet apo adresa e postës elektronike;

b) komunikimi lidhur me mallrat, shërbimet, imazhin e një sipërmarrjeje, organizate apo personi, i ofruar në mënyrë të pavarur dhe pa kundërshpërblim.

5. “Kriter” është çdo detyrim, ndalim, kusht apo kufizim, i parashikuar në legjislacionin sektorial. Rregullat e parashikuara në kontratat kolektive të punës nuk konsiderohen si kritere, sipas kuptimit të këtij ligji.

6. “Legjislacion sektorial” është legjislacioni, duke përfshirë ligje, vendime, rregullore, udhëzime dhe çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor, si dhe rregullat e parashikuara sipas akteve të urdhrave ose organizatave profesionale, që rregullojnë ushtrimin e veprimtarive në një sektor të caktuar.

7. “Ministria” është ministria që mbulon çështjet e tregtisë.

8. “Ofruer” është çdo person fizik apo juridik, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili ofron apo realizon një shërbim.

9. “Përfitues apo marrës shërbimi” është çdo person fizik ose juridik, shtetas shqiptar apo i huaj, i cili, për qëllime profesionale ose jo, përdor apo dëshiron të përdorë një shërbim.

10. “Profesion i rregulluar” është çdo veprimtari profesionale apo grup veprimtarish profesionale, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin shqiptar në fuqi për profesionet e rregulluara.

11. “Skemë autorizimi” është çdo procedurë apo akt administrativ, në bazë të së cilës një autoritet kompetent i jep ofruesit ose përfituesit të një shërbimi një vendim zyrtar ose të nënkuptuar për ofrimin e një shërbimi apo aksesin në një veprimtari shërbimi.

Në kuptim të këtij ligji, termat licencë, leje, autorizim, certifikatë, pëlqim, regjistrim pranë ndonjë urdhri apo organizate profesionale, njoftim, si edhe çdo term tjetër i ngjashëm me to në legjislacionin shqiptar në fuqi, nëpërmjet të cilit lejohet ose kufizohet ushtrimi i një aktiviteti apo ofrimi i një shërbimi, do të konsiderohen si skemë autorizimi.

12. “Shërbim” është çdo veprimtari ekonomike, e kryer nëpërmjet vetëpunësimit, kundrejt një shpërblimi, si edhe çdo lloj veprimtarie me karakter intelektual, e zhvilluar në formën e sipërmarrjes apo në atë profesionale, në mënyrë të pavarur dhe kundrejt një shpërblimi.

13. “Shërbime ekonomike me interes të përgjithshëm” janë shërbimet me interes të përgjithshëm, që ofrohen kundrejt një shpërblimi.

14. “Shërbime joekonomike me interes të përgjithshëm” janë shërbimet me interes të përgjithshëm, që ofrohen pa shpërblim.

15. “Themelim dhe ushtrim i aktivitetit” është ushtrimi faktik i një veprimtarie ekonomike nga ofruesi i shërbimit, për një periudhë të pacaktuar dhe nëpërmjet një selie të përhershme në Republikën e Shqipërisë.



KREU II
E DREJTA E THEMELIMIT DHE
SKEMAT E AUTORIZIMIT

Seksioni 1

E drejta e themelimit

Neni 4

Parime të përgjithshme

Ushtrimi i veprimtarisë së shërbimit, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga persona fizikë ose juridikë, duhet të përmbushë këto kritere:

a) të mos kushtëzohet nga kritere diskriminuuese;

b) nëse kufizohet, KUFIZIMI DUHET TË VENDOSSET VETËM PËR NJË ARSYE MADHORE, që lidhet me interesin publik;

c) kufizimet, sipas shkronjës “b”, të këtij neni, në rast se ka të tilla, duhet të jenë të përshtatshme për arritjen e qëllimit të përcaktuar dhe të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij qëllimi.

Neni 5

Kriteret e ndaluara

Ushtrimi i veprimtarisë për ofrimin e një shërbimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga persona fizikë ose juridikë, të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, nuk mund të kushtëzohet, në asnjë rast, nga:

1. Zbatimi i kriterëve diskriminues, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me shtetësinë apo, në rastin e shoqërive tregtare, me vendndodhjen e selisë, përfshirë, në mënyrë të veçantë:

i) kritere që ofruesi i shërbimit, personeli i tij, aksionarët, ortakët ose anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të jenë shtetas shqiptarë;

ii) kritere që ofruesi i shërbimit, personeli i tij, aksionarët, ortakët ose anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të jenë të pajisur me leje qëndrimi, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Kërkesa për paraqitjen, rast pas rasti, të testit ekonomik, nga ofruesi i shërbimit, si kusht për pajisjen me autorizim, për të vërtetuar një nevojë ekonomike apo kërkesë të tregut, për të vlerësuar efektet ekonomike të mundshme apo faktike të

veprimtarisë, si dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e veprimtarisë, në lidhje me objektivat e planifikimit ekonomik, të përcaktuara nga autoriteti kompetent.

3. Përfshirja, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, e subjekteve konkurrenente në dhënien e autorizimeve, përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në organizmat konsultativë, me përjashtim të organizatave dhe shoqatave profesionale apo organizatave të tjera, që veprojnë si autoritet kompetent. Ky ndalim nuk ka të bëjë me konsultimin e organizatave, të tilla si dhomat e tregtisë apo shoqatat e biznesit, për çështje që nuk kanë lidhje me aplikime specifike për autorizim ose konsultimin e publikut.

4. Detyrimi për të dhënë apo për të qenë pjesë e një garancie financiare ose për t'u siguruar nga një ofrues apo organizëm i vendosur në territorin e tyre. Kjo dispozitë nuk kufizon të drejtën e autoriteteve kompetente për të kërkuar sigurimin ose një garanci financiare vetëm në rastet e një arsyeje madhore, që lidhet me një interes publik.

5. Detyrimi që të kenë qenë të regjistruar, për një periudhë të caktuar, në regjistrat e mbajtur në vendin e tyre, ose të kenë ushtruar, më parë, veprimtarinë në territorin e tyre.

Neni 6

Kritere që duhen vlerësuar

1. Kriteret që duhet të vlerësohen, nëse janë të domosdoshme, janë:

a) kufizimet sasiore apo territoriale, veçanërisht në formën e një numri të caktuar popullsie apo distance minimale ndërmjet ofruesve të shërbimit;

b) detyrimi i ofruesit për të pasur një formë të caktuar juridike;

c) kërkesa që lidhen me zotërimin e kuotave ose aksioneve të një shoqërie;

ç) kërkesa, sipas të cilave e drejta e ofrimit të një shërbimi të caktuar, përjashtuar profesionet e rregulluara, për shkak të natyrës specifike të veprimtarisë, u jepet ofruesve të caktuar;

d) ndalimi për të pasur më shumë se një zyrë brenda territorit;

dh) kërkesa për të pasur një numër minimal punonjësish;

e) vendosja e tarifave minimale dhe/ose maksimale, të cilave duhet t'u përmbahet ofruesi i shërbimit;



ë) detyrimi ndaj një ofruesi që, bashkë me shërbimin e tij, të ofrojë edhe shërbime të tjera specifike.

2. Kriteret e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, duhet të respektojnë, në të gjitha rastet, parimet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji. Autoritetet përgjegjëse duhet të vlerësojnë, rast pas rasti, nëse legjislacioni i ri sektorial respekton përcaktimet e këtij ligji.

3. Autoritetet përgjegjëse duhet të njoftojnë, pranë ministrisë, legjislacionin e ri sektorial, që propozon parashikimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, së bashku me arsyetimin përkatës për parashikimin e këtyre kriterëve. Ministria shqyrton përputhshmërinë e tij me këtë ligj dhe, sipas rastit, i rekomandon autoritetit përgjegjës nëse kriteri nuk duhet miratuar apo duhet shfuqizuar. Procedura e njoftimit dhe forma e vlerësimit të përputhshmërisë së legjislacionit të ri sektorial përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Seksioni 2

Skemat e autorizimit

Neni 7

Parime të përgjithshme

1. Ushtimi i veprimtarisë për ofrimin e një shërbimi në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të kushtëzohet nga pajisja me një skemë autorizimi vetëm nëse respektohen parimet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

2. Pajisja me një skemë autorizimi i jep të drejtë ofruesit të një shërbimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në të gjithë territorin, me përjashtim të rasteve kur, për shkak të një arsyeje madhore, të lidhur me interesin publik, skema e autorizimit është e vlefshme për një vendndodhje të caktuar të territorit.

3. Skema e autorizimit jepet pa një afat kohor të përcaktuar, përveç rasteve kur:

a) ajo rinovohet automatikisht ose i nënshtrohet përmbytjes së vazhdueshme të kërkesave ligjore;

b) numri i saj në dispozicion është i kufizuar, për arsye madhore, që lidhen me interesin publik;

c) vlefshmëria e kufizuar e saj justifikohet nga një arsye madhore, që lidhet me interesin publik.

4. Pavarësisht sa parashikohet në pikën 3, të këtij neni, autoritetet kompetente mund të parashikojnë një afat kohor të caktuar për një skemë autorizimi, brenda të cilit ofruesi duhet të fillojë, efektivisht, veprimtarinë e tij.

5. Në rastin e mungesës së burimeve natyrore të mjaftueshme apo nevojës për aftësi teknike, numri i skemave të autorizimit në dispozicion, për një aktivitet të caktuar, mund të kufizohet. Në këto raste, skema e autorizimit do të jepet për një periudhë të caktuar dhe mund të mos ketë rinovim automatik.

Neni 8

Kushtet për miratimin e skemave të autorizimit

1. Kriteret e çdo skeme autorizimi duhet të jenë në përputhje me parimet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Procedurat për pajisjen me një skemë autorizimi duhet të plotësojnë këto kushte:

a) të jenë të qarta, transparente, të bëra publike paraprakisht dhe të garantojnë objektivitetin, paanësinë e autoriteteve kompetente gjatë shqyrtimit të kërkesave;

b) të jenë lehtësisht të aksesueshme, të thjeshta dhe të mos shkaktojnë vonesa të panevojshme në ofrimin e shërbimit;

c) të trajtohen brenda një afati të arsyeshëm, të përcaktuar dhe të bërë publik paraprakisht. Ky afat fillon në momentin e dorëzimit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Në rastet e çështjeve të komplikuar, ky afat mund të shtyhet vetëm një herë, për një kohë të caktuar. Shtyrja e afatit dhe kohëzgjatja e tij duhet të jetë i motivuar dhe t'i njoftohet kërkuarit para mbarimit të afatit të mëparshëm;

ç) një skemë autorizimi konsiderohet e miratuar në heshtje, në përputhje me parimet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative;

d) çdo pagesë për pajisjen me një skemë autorizimi duhet të jetë e arsyeshme, në proporcion me koston e procedurave, dhe të mos e kalojë koston administrative për shërbimin;

dh) të kenë të përcaktuara procedurat e ankimit;

e) në rastet kur kërkesa është e paplotë, autoritetet kompetente duhet të njoftojnë kërkuarit për dorëzimin e dokumenteve shtesë të



nevojshme, si edhe për efektet në lidhje me shqyrtimin, sipas shkronjës “c”, të kësaj pike;

ë) në rast refuzimi të kërkesës, për shkak të mospërbushjes së procedurave të mësipërme, kërkuesi duhet të njoftohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Çdo vendim i autoriteteve kompetente, përfshirë refuzimin apo anulimin e një skeme autorizimi, duhet të jetë i arsyetuar. Ky vendim mund të ankimohet, në përputhje me procedurat e ankimit administrativ, të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Procedurat përzgjedhëse

1. Në rastet kur numri i skemave autorizuese në dispozicion është i kufizuar, siç parashikohet në pikën 5, të nenit 7, të këtij ligji, zhvillohet një procedurë përzgjedhëse ndërmjet kandidatëve të mundshëm.

2. Procedura e parashikuar sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jetë e paanshme, transparente dhe të bëhet publike në të gjitha fazat e procesit përzgjedhës.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kohëzgjatja e skemës së autorizimit mund të jetë e kufizuar në kohë dhe e parinovueshme automatikisht.

4. Për përcaktimin e rregullave për procedurat përzgjedhëse duhet të merren parasysh të gjitha kriteret që lidhen me interesin publik.

KREU III

PIKA E VETME E KONTAKTIT

Neni 10

Krijimi i Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK)

1. Pika e Vetme e Kontaktit (PVK) është një portal elektronik, nëpërmjet të cilit ofruesit e shërbimeve mund të kryejnë procedurat:

a) për fillimin e veprimtarisë së tyre, lidhur me deklaratimet, njoftimet apo kërkesat e nevojshme për pajisje me skemë autorizimi nga autoritetet kompetente, përfshirë edhe aplikimin, regjistrimin në një regjistër, listë apo bazë të dhënash, ose për regjistrimin pranë një organi apo organizate profesionale;

b) për çdo aplikim për pajisjen me autorizimin e nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së tij të shërbimit.

2. PVK-ja nuk cenon kompetencat dhe funksionet e autoriteteve përgjegjëse për kryerjen e këtyre procedurave, të parashikuara me ligj.

3. PVK-ja është pjesë e portalit *e-Albania* dhe administrohet nga autoritetet kompetente për këtë portal, si edhe autoritetet e tjera kompetente përgjegjëse, sipas fushave. Mënyra e funksionimit të PVK-së miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Përmbajtja e Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK)

1. Nëpërmjet PVK-së, ofruesve dhe përfituesve të shërbimeve u sigurohet i gjithë informacioni i nevojshëm për:

a) kërkesat, në lidhje me procedurat dhe formalitetet që duhen plotësuar për fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë;

b) kontaktet e autoriteteve kompetente, që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve;

c) mjetet dhe kushtet për hyrjen në regjistrat publikë e në bazat e të dhënave për ofruesit dhe shërbimet;

ç) mjetet e ankimit në dispozicion, në rast të mosmarrëveshjeve ndërmjet autoriteteve kompetente dhe ofruesit apo përfituesit të shërbimit, ndërmjet një ofruesi dhe një përfituesi apo ndërmjet ofruesve;

d) kontaktet e shoqatave apo organizatave, të ndryshme nga autoritetet kompetente, të cilat mund të ndihmojnë ofruesit apo përfituesit.

2. Informacioni, i parashikuar sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm në mënyrë elektronike dhe të jetë i përditësuar, në gjuhën shqipe dhe angleze.

3. PVK-ja dhe autoritetet kompetente duhet të përgjigjen, në përputhje me afatet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative, ndaj çdo kërkesë për informacion apo ndihme, sipas pikave 1 e 2, të këtij neni, dhe, në rastet kur kjo kërkesë ka të meta apo është e pabazuar, të informojnë kërkuenin.

4. Detyrimi i autoriteteve kompetente për të ndihmuar ofruesit dhe përfituesit e shërbimeve nuk nënkupton ofrimin e këshillimit ligjor për çështje të caktuara, por vetëm dhënien e informacionit të përgjithshëm për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të kërkesave ligjore.



Neni 12

Procedurat në mënyrë elektronike

1. Të gjitha procedurat dhe formalitetet që lidhen me aksesin në një veprimtari shërbimi apo ushtrimin e saj mund të kryhen edhe në mënyrë elektronike, nëpërmjet PVK-së, dhe pranë autoriteteve kompetente përkatëse.

2. Rregullat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, nuk zbatohen në rastin e inspektimit të ambienteve ku ofrohet shërbimi dhe të pajisjeve të përdorura për këtë qëllim, apo për këqyrjen fizike të aftësive të ofruesit ose të personelit të tij përgjegjës.

KREU IV

TË DREJTAT E PËRFITUESVE DHE CILËSIA E SHËRBIMEVE

Neni 13

Të drejtat e përfituesve të shërbimeve

1. Çdo person fizik, shqiptar apo i huaj, mund të përfitojë nga shërbimet e ofruara në territorin e Republikës së Shqipërisë pa qenë i detyruar të pajiset me një autorizim apo të bëjë deklaratë para autoriteteve kompetente për këtë qëllim.

2. Kushtet e përgjithshme për përfitimin e një shërbimi të caktuar, të bëra publike nga ofruesi, nuk mund të përmbajnë kritere diskriminuese, lidhur me shtetësinë apo vendin e qëndrimit të përfituesit. Ndryshimet, në kushtet për përfitimin nga shërbimi, janë të mundshme kur justifikohen nga kritere objektive.

3. Përfituesit e shërbimeve kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin:

a) informacion të përgjithshëm për kërkesat e zbatueshme për ushtrimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve e përfitimin prej tyre dhe, sidomos, për ato që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve;

b) informacion të përgjithshëm për mjetet e ankimit, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet ofruesit dhe përfituesit;

c) pikat e kontaktit të shoqatave apo organizatave, nga të cilat mund të informohen ofruesit apo përfituesit.

Informacioni dhe ndihma e mësipërme duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm në mënyrë elektronike dhe i përditësuar.

Neni 14

Informacion për ofruesit dhe shërbimet e tyre

1. Ofruesit e shërbimeve duhet të vënë në dispozicion të përfituesve informacionin si më poshtë:

a) emrin, statusin dhe formën juridike të ofruesit, adresën, ku të jenë përcaktuar edhe të dhëna për kontaktim e komunikim të drejtpërdrejtë, sipas rastit, edhe në mënyrë elektronike;

b) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS);

c) në rastin kur veprimtaria është objekt i autorizimit, të dhëna për autoritetin kompetent për këtë qëllim apo PVK-në;

ç) në rastin e profesioneve të rregulluara, organin profesional apo ndonjë institucion të ngjashëm, ku ofruesi është regjistruar, titullin profesional dhe vendin ku e ka fituar këtë titull;

d) kushtet dhe klauzolat e përgjithshme, nëse ka, që përdor ofruesi;

dh) klauzolat kontraktore, nëse ka, të përdorura nga ofruesi, në lidhje me dispozitat e zbatueshme dhe/ose gjykatat kompetente;

e) garancitë pas shitjes, nëse ka;

ë) çmimin e shërbimit, kur, për një shërbim të caktuar, është paracaktuar një çmim;

f) karakteristikat kryesore të shërbimit, nëse nuk janë të qarta nga konteksti.

2. Informacioni i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, duhet të sigurohet nga ofruesi në një nga këto mënyra:

a) të jepet nga ofruesi me nismën e vet;

b) t'i vihet në dispozicion përfituesit në vendin e ofrimit të shërbimit apo ku lidhet kontrata;

c) t'i vihet në dispozicion përfituesit në mënyrë elektronike, nëpërmjet një adrese të vendosur nga ofruesi;

ç) të përfshihet në dokumentet informative, ku jepet një përshkrim i detajuar i shërbimit që ofrohet dhe që i jepet përfituesit nga ofruesi.

3. Me kërkesë të përfituesve, ofruesit duhet të paraqesin informacionin e mëposhtëm shtesë:

a) çmimin, në rastet kur, për një shërbim të caktuar, ky nuk është paracaktuar, ose, kur një çmim i saktë nuk mund të jepet, mënyrën e përlogaritjes së tij apo një vlerë të përafërt të detajuar;



b) rregullat profesionale të zbatueshme, sa u takon profesioneve të rregulluara, dhe ku gjenden ato;

c) informacion për veprimtaritë e tjera apo partneritetet, të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimin e ofruar, dhe masat e marra për të shmangur konfliktin e interesit. Ky informacion duhet të përfshihet në çdo dokument informues, ku ofruesi jep një përshkrim të detajuar të shërbimit të tij;

ç) kodin e sjelljes, mbi të cilin mbështetet ofruesi, si dhe adresën në të cilat këto kode mund të konsultohen, në mënyrë elektronike, me treguesin e versioneve gjuhësore të mundshme, nëse ka;

d) në rastet kur ofruesi është anëtar i ndonjë shoqate apo organizate profesionale, që ofron mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rrugë jashtëgjyqësore, ofruesi duhet të specifikojë karakteristikat dhe kushtet e zbatimit të saj.

4. Informacioni i parashikuar në këtë nen duhet të ofrohet në kohë të mjaftueshme, përpara nënshkrimit të kontratës apo, në mungesë të një kontrate të shkruar, përpara ofrimit të shërbimit.

Neni 15

Komunikimet tregtare nga profesionet e rregulluara

1. Çdo kufizim lidhur me komunikimet tregtare është i ndaluar, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj. Komunikimet tregtare, nga profesionet e rregulluara, duhet të jenë në përputhje me rregullat profesionale që lidhen, sidomos, me pavarësinë, dinjitetin, integritetin e profesionit dhe me sekretin profesional, në mënyrë që të përputhen me natyrën specifike të çdo profesioni.

2. Rregullat profesionale për komunikimet tregtare duhet të jenë jodiskriminuese dhe të justifikueshme nga një arsye madhore, që lidhet me interesin publik dhe proporcional.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 16

Dispozita kalimtare

1. Në përputhje me dispozitat e neneve 4 - 9, të këtij ligji, brenda tre vjetëve, nga hyrja në fuqi e

tij, duhet të shqyrtohen të gjitha kriteret dhe dispozitat ekzistuese, për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë ligj, ose, sipas rastit, ndryshimin e tyre.

2. Autoritetet përgjegjëse për rishikimin e legjislacionit dhe metodologjia e shqyrtimit të përputhshmërisë së kriterëve ekzistuese me këtë ligj do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6, pika 3, dhe nenit 16, pika 2.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 10, pika 3.

Neni 18

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi tre muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Dispozitat e parashikuara nga kreu III, i këtij ligji, i fillojnë efektet e tyre pesë vjet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Miraturar në datën 9.6.2016

Shpallur me dekreten nr. 9649, datë 21.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**VENDIM
Nr. 40/2016**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETI NR. 9577,
DATË 5.5.2016, TË PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E
LIGJIT NR. 43/2016, “PËR
MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”“**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:



I. Rrëzimin e dekretit nr. 9577, datë 5.5.2016, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 9.6.2016

VENDIM
Nr. 41/2016

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT
HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË
KONTROLLUAR ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR
ADMINISTRIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TATIMORE,
NGRITUR ME VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 8/2016**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, bazuar në pikën VI të vendimit të Kuvendit nr. 8/2016, “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazës së të dhënave shtetërore tatimore”, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit Hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazës së të dhënave shtetërore tatimore, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 8/2016, zgjatet për një periudhë 1-mujore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 9.6.2016

VENDIM
Nr. 42/2016

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT
TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REFORMËN ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore zgjatet për një periudhë 6-mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 9.6.2016

VENDIM
Nr. 455, datë 22.6.2016

**PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË
SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË
Z. SPARTAK BRAHO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016” dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 33, datë 20.1.2016 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Spartak Braho, në masën 4 800 000 (katër milionë e tetëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.



4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 466, datë 22.6.2016

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR.1093, DATË 28.12.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
PROCEDURAVE, TË KRITEREVE DHE
PËRPARËSIVE, PËR DHËNIEN E
BONUSIT TË STREHIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 14, të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 9, të vendimit nr.1093, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Përfundimisht për vitin 2016, edhe në rastet kur njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë fonde të miratuara në buxhetin e tyre për bonus strehimi, buxheti i shtetit do të përballojë deri në 50% të qirasë, ndërkohë që pjesën e mbetur e përballon qytetari që përfiton bonusin e strehimit. Bashkitë paraqesin kërkesat për bonus strehimi brenda datës 30 shtator 2016.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Urban për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë